

Elbasan, me \_\_\_\_ .01. 2023

**PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** “Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike të objekteve të shoqërisë”  
Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj”.

---

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 98341140-8  
shërbime sigurimi**

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 87,047,490 (tetëdhjetë e shtatë milion e dyzet e shtatë mijë e katërqind e nëntëdhjetë) lekë, **pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës nr. 3*

*b. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 9*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

---

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8. (Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

---

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** OE duhet të dorëzojë kopje të deklaratave të xhiros për tre vitet e fundit nga data e zhvillimit të tenderit (2019,2020,2021) ku vlera e xhiros në të paktën njërin nga vitet të jetë jo më e vogël se 80,000,000 (tetëdhjetë milion).

*Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

**2.2.2** OE duhet të dorëzojë kopje të bilanceve të audituara nga ekspertët kontabël të licensuar të konfirmuara nga autoritetet përkatëse të Administratës Tatimore të tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit (2019, 2020, 2021) ku të paktën në dy bilancet e njëpasnjëshme nuk ka raport negativ midis aktivitetit dhe pasivit. Akt Ekspertiza e ekspertit kontabël të autorizuar duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastet kur janë kushtet e përcaktuara nga neni 41 /c të ligjit nr.10091 dt. 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 date 5.3.2009 ”Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.

---

## **Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1** OE duhet të paraqesë dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit limit të MK, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të

kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke pasur parasysh se shërbimi i sigurisë për ruajtjen e ndërtesave, aseteve, njerëzve dhe pronave është një shërbim shumë i rëndësishëm, është parë e arsyeshme që operatori ekonomik duhet të ketë eksepriencë të mëparshme për të garantuar shërbimin e kërkuar dhe për të vërtetuar aftësitë e tij.

---

### 2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë si me poshtë:

- a) *Liçencë e shoqërisë për ushtrimin e aktivitetit në fushën e “Shërbimi privat të sigurisë fizike”, lëshuar në bazë të Ligjit nr. 75/2014, nën-kategoria 1.3.A.*
- b) *Çertifikatë e Titullarit të Subjektit, e vlefshme për ushtrimin e aktivitetit në fushën e “Shërbimi privat të sigurisë fizike”, nën-kategoria 1.3.A, lëshuar në bazë të Ligjit nr. 75/2014 dhe Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr.130, datë 05.03.2018.*
- c) *Çertifikatë e Drejtuesit Teknik, e vlefshme për ushtrimin e aktivitetit në fushën e “Shërbimi privat të sigurisë fizike”, nën-kategoria 1.3.A, lëshuar në bazë të Ligjit nr. 75/2014 dhe Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr.130, datë 05.03.2018.*
- d) *Çertifikatat e punonjësve të shërbimit, të vlefshme për ushtrimin e aktivitetit në fushën e “Shërbimi privat të sigurisë fizike”, nën-kategoria 1.3.A, lëshuar në bazë të Ligjit nr. 75/2014 dhe Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr.130, datë 05.03.2018, për të paktën 45 (dyzet e pesë) punonjës shërbimi, të lëshuara nga Drejtoria Vendore e Policisë ku ushtron veprimtarinë subjekti.*
- e) *Autorizim individual, lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, konform Ligjit Nr.9918 datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit operatori ekonomik të jetë liçencuar për përdorim të frekuencave për radiokomunikim dhe radio-alarm në zonat ku ndodhen objektet ku do të kryhet shërbimi.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ligjit.75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” si dhe Ligjit Nr.9918 datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

---

**2.3.3.** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor**, si më poshtë:

- a) Operatori Ekonomik të ketë Qëndër Kontrolli. Për të provuar ekzistencën e saj të paraqitet Akti i Miratimit i Qendrës së Kontrollit, konform nenit nr. 22 të Ligjit nr.75/2014, miratuar nga Drejtoria Vendore e Policisë ku ushtron veprimtarinë subjektive.
- b) Operatori Ekonomik të paraqesë Vërtetim Performance nga Drejtoria Vendore e Policisë , lëshuar jo më parë se 30 ditë nga data e hapjes së ofertave, ku të jepet informacioni si më poshtë:
  - i. Për numrin e punonjësve të shërbimit gjithsej, jo më pak se **45** (dyzetë e pesë) punonjës, të çertifikuar në bazë të ligjit nr.75/2014.
  - ii. Të ketë Përgjegjës Shërbimi.
  - iii. Të ketë në funksionim Qendrën e Kontrollit.
  - iv. Të ketë në ruajtje objekte me verifikim sinjal alarmi, jo më pak se 9 (nëntë) objekte.
  - v. Të ketë Grup të gatshëm punonjësish për verifikim të sinjaleve të alarmit.
  - vi. Që nuk ka masë administrative për operatorin ekonomik (Subjektin), Titullarin e Subjektit dhe Drejtuesin Teknik, sipas përcaktimeve të kreut V, të Ligjit nr.75/2014, gjatë viteve 2020, 2021, 2022.
  - vii. Që nuk ka ngjarje të ndodhura në objektet ku ka kryer dhe kryen shërbim gjatë viteve 2020, 2021, 2022.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe ligji 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë kapacitetet teknike, stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar si dhe besueshmërinë për realizimin me sukses të kontratës. Informacioni i kërkuar, si psh nr. i punonjësve të shërbimit, numri i objekteve me sinjal alarmi që duhet të ofroje këtë shërbim, janë në përputhje me përmasat e kontratës që do të realizohet, e konkretisht me numrin e objekteve/vendrojeve ku do të kryhet shërbimi, dhe numrin e punonjësve të shërbimit që do të kryejnë shërbim.

---

**2.3.4.** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 47 persona**, 45 punonjës shërbimi si dhe drejtuesin teknik dhe administratorin.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Ky kriter është specifikuar si më poshtë:

- a) Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguar për 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, shoqëruar me listë pagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë të konfirmuara nga organet tatimore. Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht **47 (dyzetë e shtatë)** punonjës të siguar në muaj, **45** punonjës shërbimi si dhe drejtuesin teknik dhe administratorin/titullarin e subjektit.

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga Operatorët Ekonomikë të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 9 të DST-ve.

Në rast se operatori shpallet fitues, përpara lidhjes së kontratës duhet të dorëzojë dokumentat provuese për vetëdeklarimet që ka bërë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (vërtetimin dhe listëpagesat, neni 82, pika 5/b LPP)

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë:

Duke llogaritur numrin e objekteve për të cilat kërkohet shërbimi me roje, numri i vendrojeve si dhe orari i shërbimit duke përllogaritur turni I, II, dhe III.

---

**2.3.5.** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

- a) Operatori ofertues të disponojë automjete, në emër të shoqërisë, në pronësi apo të marra me qira, për ndërhyrjet në raste emergjente, jo më pak se 5 (pesë) automjet për përballimin e situatave emergjente.
  - i. Pronësia e automjeteve të vërtetohet duke paraqitur lejen e qarkullimit të tyre, siguracion të vlefshëm, akt-kolaudimi të vlefshëm dhe taksa të paguara.
  - ii. Marrja me qira ose huapërdorja e automjeteve të mësipërm, do të pranohet vetëm nëse kontrata/t e qiramarrjes ose të huapërdorjes janë të lidhura para noterit, dhe të shoqëruara me lejen e qarkullimit, siguracion të vlefshëm, akt-kolaudimi të vlefshëm dhe taksa të paguara.

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga Operatorët Ekonomikë të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 9 të DST-ve.

Në rast se operatori shpallet fitues, përpara lidhjes së kontratës duhet të dorëzojë dokumentat provuese për vetëdeklarimet që ka bërë në formularin përmbledhës të vetë deklarimit (dokumentacioni i plotë ligjor i mjeteve, neni 82, pika 5/b LPP)

b) Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë se disponon në pronësi jo më pak se **9** (nëntë) armë zjarri (krahu ose brezi). Për të vërtetuar këtë duhet të paraqesë:

1. Autorizim për blerje arme **zjarri** lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë.
2. Kontrate shitblerje arme me një shoqëri të licensuar për shitblerje armësh shoqëruar me numrin serial për secilën armë.
3. Faturat tatimore shoqëruar me mandat pagesat e bankës, që konfirmon kryerjen e pagesës.

Për sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se në dokumentat e tenderit është përcaktuar qartësisht se kategoria e shërbimit përfshin disponimin e kategorisë së Licensës / Licensave 1.3.A për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike, kështu që edhe armët e kërkuara në këtë objekt prokurimi do të përdoren për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike me Roje Private të subjekteve të Licensuara me Kategorinë 1.3.A.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Automjetet janë kërkuar për raste të ndërhyrjes emergjente, verifikimin e sinjaleve të alarmit si dhe patrullim nga Grupi i Gatshëm pranë objekteve që do të ruhen nga OE. Numri i automjeteve është kërkuar në bazë të numrit të objekteve që do të ruhen, gjithsej janë 9 (nëntë) objekte/vendroje, dhe shpërndarjes së objekteve/vendrojeve në sipas qyteteve perkatese. Dhe 4 automjetet e kërkuara nga AK janë të mjaftueshme për kryerjen e objektit të prokurimit.

Kriteri për pronësinë e armëve (të gjata dhe të shkurtra) bazohet në nenin 7 e vijues të Ligjit 74/2014 “Për armët” si dhe nenet 32, 33, 34, 35 të Ligjit 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”. Numri i armëve 9 (nëntë), është përcaktuar në bazë të numrit të vendrojeve 9 (nëntë).

---

## **2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

**2.4.1** *Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin analizën e kostos për ofertën e paraqitur (preventiv për një roje në muaj). Operatorët ekonomikë duhet të përcaktojnë çmimin e ofertës duke respektuar aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi (si psh: pagë bazë, shtesat mbi pagë turni I+III, sigurimet shoqërore...etj). Ofertat që nuk respektojnë kërkesat ligjore do të konsiderohen nënkoston ligjore dhe do të skualifikohen.*

---

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

### Shtojca 5.

*[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]*

#### **FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

#### **1. Shërbimi i ruajtjes fizike:**

- a) Rojat duhet të jenë të pajisur me mjete mbrojtëse, me uniforma dhe dokument identifikimi dhe mjete të tjera logjistike siç parashikohet nga ligji 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike".
- b) Të ruaj objektin që i është besuar, të ruajë rendin në to, si dhe të sigurojë jetën e personelit.

#### **2. Shërbimi i ruajtjes me Alarm.**

- a) Shërbimi i ruajtjes dhe i sigurisë së objekteve përveç se me punonjës shërbimi në çdo objekt, do të kryhet edhe me sinjal alarmi gjatë orareve 16.<sup>00</sup> - 08.<sup>00</sup>, çdo ditë të javës, edhe në ditët e festave zyrtare.
- b) Shërbimi i ruajtjes me sistem alarmi do të ofrohet për mjediset e brendshme të objekteve (sensor të brendshëm).
- c) Do të vendoset të paktën 1(një) sistem alarmi për çdo objekt.

- d) Sistemet e Alarmit janë Sisteme teknologjike elektronike moderne për sinjalizimin e hyrjes apo dëmtimeve të paligjshme në ambientin e marrë në ruajtje.
- e) Përgjegjësit e objekteve garantojnë aktivizimin dhe ç'aktivizimin e alarmit në momentin e mbylljes dhe hapjes së objektit.
- f) Shoqëria e Sigurisë mban përgjegjësi pas aktivizimit të sistemit të alarmit në rast se vjedhja apo dëmtimi i materialeve në objektin e siguruar, ka ardhur si pasojë e neglizhencës së shërbimeve të kësaj shoqërie.
- g) Montimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve të sistemit të alarmit janë përgjegjësi e shoqërisë private të sigurisë.
- h) Sistemet e Alarmit të jenë me transmetim me Radio, me GSM ose me GPRS, me sistem mbyllje me pult ose me tastierë me kod, me sensorë me kabëll ose me wireless.
- i) Të gjitha shpenzimet e mirëmbajtjes, për pjesë ndërrimi, paisjet e zëvendësuara, zëvendësimin e baterive, sensorë të ndryshëm, DVR, Centrale të sistemeve të alarmit, kabëll rrjeti etj, gjatë procesit të shërbimit periodik dhe në periudhën e garancisë, do të mbulohen nga vetë shoqëria e sigurimit për gjithë kohën e parashikuar në kontratë.

## **1. Kërkesat për zbatimin e shërbimit**

- Punonjësit e shërbimit të jenë të licensuar me lejet përkatëse të lëshuara nga Drejtoria e Policisë së Qarkut ku prokurohet në bazë të Ligjit Nr. 75/2014.
- Punonjësit e shërbimit të jenë të pajisur me uniformë të rregullt të miratuar nga Ministria e Brendshme, ku të jetë e reklamuar dhe stema e shoqërisë dhe të kenë dokumente që vërtetojnë identitetin e tyre
- Rojet duhet të kenë në përdorim për realizimin e shërbimit të ruajtjes, radio komunikimi.
- Rojet duhet të kenë leje arme.
- Në vend roje duhet të jenë këto dokumenta:
  - a-Rregullorja e brendshme
  - b-Libri i marrjes në dorëzim të shërbimit, i cili duhet të plotësohet nga punonjësi i shërbimit.
  - c-Grafiku mujor i shërbimit me emrat e personelit për çdo ditë dhe turn.
  - d-Mjete ndriçimi në rast mungese të energjisë elektrike.
  - e-Numrat telefonikë të rajoneve të policisë, zjarrëfikësve dhe të personave kryesorë e përgjegjës të objektit.
  - f-Skemën e njoftimit në rast sulmi ose zjarri në objekt.
  - g-Listën e automjeteve që lejohen të hyjnë apo të parkohen në objekt.

## Shtojca 6

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

### FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

**Shërbimi që kërkohet:** “Shërbim i ruajtjes dhe sigurisë fizike i objekteve të Sh.a Ujësjiellës Kanalizime Elbasan, me punonjës shërbimi dhe sisteme alarmi të sinjalizimit”.

**Afatet e ekzekutimit:** 24 muaj

**Vendndodhja e shërbimit:**

## Shtojca 7

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

### FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

#### **A. Objekte të Shoqërisë që do të ruhen me roje fizike:**

Shpërndarja:

1. **Stacioni i Pompave të Ujit & Pusi nr. 4 në Krastën e Vogël** do të sigurohet me një vend shërbimi dhe 4.98 punonjës shërbimi me sistem 24 orësh (**gjithsej 730 orë pune**).
2. **Stacioni i Pompave të Ujit në Mengël** do të sigurohet me një vend shërbimi dhe 4.98 punonjës shërbimi me sistem 24 orësh (**gjithsej 730 orë pune**).
3. **Stacioni i Pompave të Ujit tek Frigoriferi** do të sigurohet me një vend shërbimi dhe 4.98 punonjës shërbimi me sistem 24 orësh (**gjithsej 730 orë pune**).
4. **Stacioni i Pompave të Ujit tek ish-Fabrika e “Alkoolit”** do të sigurohet me një vend shërbimi dhe 4.98 punonjës shërbimi me sistem 24 orësh (**gjithsej 730 orë pune**).
5. **Depo e Ujit në Krastën e Vogël** do të sigurohet me një vend shërbimi dhe 4.98 punonjës shërbimi me sistem 24 orësh (**gjithsej 730 orë pune**).
6. **Depo e Ujit në Krastën e Madhe** do të sigurohet me një vend shërbimi dhe 4.98 punonjës shërbimi me sistem 24 orësh (**gjithsej 730 orë pune**).
7. **Depo e Ujit në Lagjen “Haxhias”** do të sigurohet me një vend shërbimi dhe 4.98 punonjës shërbimi me sistem 24 orësh (**gjithsej 730 orë pune**).
8. **Depo e Ujit në Lagjen “5 Maji” Harmës** do të sigurohet me një vend shërbimi dhe 4.98 punonjës shërbimi me sistem 24 orësh (**gjithsej 730 orë pune**).
9. **Ish zyrtat UKE sha në NSHU, Elbasan** do të sigurohet me një vend shërbimi dhe 3.32 punonjës shërbimi nga dita e hënë në të hënë prej orës 16<sup>00</sup>-08<sup>00</sup> (**gjithsej 488 orë pune**)

**Numri total i punonjësve = 43.16**

**Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:**

1. Shërbimi Privat i Sigurisë Fizike, kërkohet për 9 (nëntë) objektet e mësipërm. Vendndodhja e rojeve do jetë brenda territorit/rrethimit të këtyre objekteve. Shërbimi do të kryhet në të gjitha objektet, stacionet e pompave, depot e ujit dhe ish zyrat e UKE sha, (NSHU) sipas vendndodhjes dhe shpërndarjes teritoriale të objekteve.
2. Sh.P.S.Fizik të kryhet në zbatim të Ligjit 75/2014, Urdhrit të Ministrit të Brendshëm nr.155 datë 29.05.2014, pika 3/a (për objektet e rëndësisë së veçantë, si depo uji...etj) si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tyre me armatim, uniformë, pajisje ndërlidhje dhe mjet transporti. Organizimi i shërbimit të bëhet me plan skicimi e dislokimi në vendosjen dhe shtrirjen e shërbimeve. Në çdo vendshërbim të ketë libër shërbimi për marrjen dhe dorëzimin e detyrës me instruktazhin e nevojshëm nga Drejtuesi Teknik i Shoqërisë.
3. Punonjësit e shërbimit të jenë të çertifikuar konform Ligjit 75/2014, gjatë ushtrimit të detyrës punonjësi të jetë i pajisur me uniformën, shenjën dalluese, emblemën, stemën e shoqërisë, dokumentin identifikues si dhe pajimet personale si shkop gome, hekura lidhës, rrip multifunksional, konform Udhëzimit të MB nr.157, datë 01.04.2015 “Për funksionimin e Shpsf”, si dhe të kenë kontrata pune me operatorin ekonomik.
4. Të sigurojë 2 (dy) grupe të gatshme me punonjës shërbimi në mbështetje të njësive të shërbimit në terren për ndërhyrjen dhe parandalimin e rasteve të ngjarjeve. Grupi i shërbimit të jetë i pajisur me uniformë, armatim me autorizimin e përdorimit, ndërlidhje, automjet me logon e shoqërisë, si dhe pajisje të tjera speciale për ndërhyrje në raste emergjence.
5. Të vërë në dispozicion për sigurimin e objekteve, stacionet e pompave, depot e ujit, qendrën e kontrollit, të pajisur me sistem ndërlidhje, radiokomunikimi, radioalarmi dhe të ofrojë shërbim/monitorimi 24 orë për menaxhimin e shërbimit.
6. Të mbulojë të gjitha shpenzimet si detyrimet fiskale, paga e rojeve, sigurimet shoqërore të personelit të punësuar nga ana e tij për ruajtjen e objekteve, shpenzimet për uniformat, armatime, ndërlidhje si dhe gjithë kompesimet e tjera të njohura me ligj.
7. Kontraktori mban përgjegjësi për dëmtimet apo vjedhjet që mund të ndodhin në objekte që ruhet nga ana e tij, kur këto vijnë si rezultat i moskryerjes me korrektësi të shërbimit apo mungesës së vigjilencës së rojeve, dhe që vërtetohet nga organet kompetente. Në këtë rast kontraktori detyrohet të bëjë ç’ dëmtimin 100% të vlerës së dëmtuar.

**Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:**

1. Objektet do të merren në dorëzim në momentin e lidhjes së kontratës nga ana e operatorit kontraktues, i cili do të mbajë përgjegjësi për dëmtimin apo vjedhjen e objekteve, pronë e ndërmarrjes.

2. Numri i punonjësve të shërbimit duhet të jetë **4.98 roje për 1 (një) vend-roje në 8 objekte dhe 3.32 roje për 1 (një) vend-roje në 1 (një) objekt, gjithsej 43.16 roje**. Firma kontraktuese është e detyruar të ruajë objektet e mësipërm me këtë numër rojesh (**43 roje**).
3. Koha e shërbimit do të jetë 24 orë, për çdo ditë kalendarike. Ruajtja dhe sigurimi fizik do të bëhet me shërbim policor 24 orësh pa ndërprerje me 3 turne shërbimi. **Vetëm në 1 (një) vendroje shërbimi, shërbimi i rojes do të jetë me 2 turne të natës për 3.32 rojet (Ish zyrat e UKE sha te “NSHU”)**. Në objektin ish zyrat UKE me shërbim 16 orë, nga ora (16.<sup>00</sup>-08.<sup>00</sup>) për çdo ditë, nga e hëna deri të premten dhe 24 orë për ditët e shtuna, të diela dhe festat zyrtare.
4. Shërbimi do të kryhet për periudhën – **24 muaj i përlogaritur sipas marrëveshjes kuadër**.
5. Firma kontraktuese është e detyruar të informojë drejtuesit e Shoqërisë Rajonale Elbasan në rastin e shkeljeve të konstatuara gjatë kryerjes së shërbimit duke mbajtur proces-verbalet përkatëse.
6. Firma kontraktuese është e detyruar të lejojë kontrolle të autorizuar nga përfaqësuesit e Shoqërisë Rajonale Elbasan në objektet që janë në ruajtje prej tij dhe nënshkruan në këto raste proces-verbalet përkatëse.
7. Punonjësit e shërbimit detyrohen të kontaktojnë me përfaqësues të Shoqërisë Rajonale Elbasan, sa herë që nevojitet, duke qenë të detyruar të zbatojnë porositë dhe urdhrat e tyre, në kuadër të ruajtjes së objekteve.
8. Kontraktuesi duhet të vërë në dispozicion Qendrën e Kontrolli (sallë operative). Të gjitha shërbimet sipas shpërndarjes së 9 objekteve, do të monitorohen 24 orë nga Qendra e Kontrollit (salla operative) e pajisur me sistem ndërlidhje, radiokomunikimi radioalarmi dhe me grup shërbimi (patrullim policor) e cila është e pajisur me uniformë, automjete shpejtlëvizëse, armatim e pajisje të tjera speciale për ndërhyrje në rast emergjence.
9. Në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Brendshëm nr.155 datë 29.05.2014, pika 3/a (për objektet e rëndësisë së veçantë, si depo uji...etj), Operatori ekonomik kontraktues duhet të ketë në pronësi, jo me pak se 9 (nëntë) armë - një për çdo vend-roje, depo uji dhe stacion të pompave të ujit.

Detyrat e punonjësit të shërbimit:

- Punonjësi i shërbimit do të kryejë shërbim sipas planizimit të shërbimit në libërin e shërbimit dhe instruktazhin e nevojshëm nga Drejtuesi Teknik i Shoqërisë.
- Punonjësi i shërbimit të komunikojë me transparencë, etikë dhe konform kërkesave të ligjit me qytetarët, eprorët dhe me çdo autoritet ligjzbatues, kur kërkohet një gjë e tillë;
- Punonjësi i shërbimit të ruajë në gjendje funksionale mjetet e ndërlidhjes e ndriçimit, si dhe pajisjet e tjera të dhëna për përmbushjen e detyrës;
- Punonjësi i shërbimit të mbajë, sipas rregullores, armatimin personal në detyrë të miratuar nga Policia e Shtetit, si dhe të përdorë armën sipas legjislacionit në fuqi;
- Punonjësi i shërbimit të kryejë detyrat për ruajtjet e vendit të ngjarjes në territorin e shërbimit, të bëjë identifikimin e personave që lidhen me ngjarjen dhe të vihet në dispozicion të strukturave të Policisë së Shtetit për hetimin e ngjarjes në objektin që

siguron; të japë informacionin në funksion të kryerjes së detyrave të Policisë së Shtetit; të vihet në dispozicion të strukturave të Policisë së Shtetit, sa herë që kërkohet, për parandalimin e veprave penale dhe zbulimin ngjarjeve të ndodhura në mjedisin ku kryen detyrën ose në ato të lidhura me detyrën;

- Punonjësi i shërbimit, para marrjes së shërbimit, kontrollon objektin në prezencë të rojes dorëzues dhe për mangësitë e konstatuara njofton përgjegjësin e rojeve dhe atë të objektit, duke bërë shënimet përkatëse në librin e shërbimit. Punonjësi i shërbimit për marrjen e detyrës sipas grafikut duhet të paraqitet 15 min. para. Punonjësi i shërbimit nuk duhet të largohet nga vendi i kryerjes së shërbimit pa u zëvendësuar dhe pa marrë miratimin e përgjegjësit të shërbimit.
- Të lejojë kontrole të autorizuara me shkrim nga drejtuesit e institucionit në objektet që janë në ruajtje prej tij dhe nënshkruan në këto raste proces-verbalet përkatëse.
- Punonjësi i shërbimit të kontrollojë masat e sigurisë së objekteve si rrethimin, ndriçimin, gadishmërinë e sistemit të ndërlidhjes, mbrojtjes ndaj zjarrit dhe për çdo parregullsi të informojë me shkrim drejtuesit e shoqërise.
- Rojet duhet të kenë leje arme.
- Në vend roje duhet të jenë këto dokumenta:

a-Rregullorja e brendshme

b-Libri i marrjes në dorëzim të shërbimit, i cili duhet të plotësohet nga punonjësi i shërbimit.

c-Grafiku mujor i shërbimit me emrat e personelit për çdo ditë dhe turn.

d-Mjete ndriçimi në rast mungese të energjisë elektrike.

e-Numrat telefonikë të rajoneve të policisë, zjarrëfikseve dhe të personave kryesorë e përgjegjës të objektit.

f-Skemën e njoftimit në rast sulmi ose zjarri në objekt.

g-Listën e automjeteve që lejohen të hyjnë apo të parkohen në objekt.

## **B. Objekte që do të ruhen me Sistem alarmi.**

| nr | Emertimi i Objektit ku do të instalohet sistemi                                                                                                                                                     | Sistem alarmi                          |
|----|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------|
| 1. | Qendra e Klientit, Lagja “5 maj”, pranë ish gjykatës Elbasan, Elbasan.<br>Shërbim i ruajtjes me 1 (një) sistem alarmi me 4 sensorë, të funksionojnë sipas orareve: 16.00-8.00 (e hënë-e premte); 24 | 1 sistem alarmi me aksesoret ndihmës + |

|    |                                                                                                                                                                                                                                                              |                                                          |
|----|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------|
|    | orë (e shtunë, e dielë dhe ditë festash zyrtare)                                                                                                                                                                                                             | sistem monitorimi                                        |
| 2. | Qendra e klientit Pallati i Sportit<br>Shërbim i ruajtjes me 1 (një) sistem alarmi me 2 sensorë, të funksionojnë sipas orareve: 16.00-8.00 (e hënë-e premte); 24 orë (e shtunë, e dielë dhe ditë festash zyrtare)                                            | 1 sistem alarmi me aksesoret ndihmës + sistem monitorimi |
| 3. | Magazina Qendrore e Shoqërisë Rajonale UK Elbasan, fshati Mengël<br>Shërbim i ruajtjes me 1 (një) sistem alarmi me 2 sensorë, të funksionojnë sipas orareve: 16.00-8.00 (e hënë-e premte); 24 orë (e shtunë, e dielë dhe ditë festash zyrtare)               | 1 sistem alarmi me aksesoret ndihmës + sistem monitorimi |
| 4  | Zyrat e Shoqërisë – L. Brigada 17 Sulmuese, ish konvikti i Shkollës së Muzikës<br>Shërbim i ruajtjes me 1 (një) sistem alarmi me 2 sensorë, të funksionojnë sipas orareve: 16.00-8.00 (e hënë-e premte); 24 orë (e shtunë, e dielë dhe ditë festash zyrtare) | 1 sistem alarmi me aksesoret ndihmës + sistem monitorimi |
| 5  | Zyrat Qendrore – L. Shënkoll, Rr. Vasil Llapushi<br>Shërbim i ruajtjes me 1 (një) sistem alarmi me 2 sensorë, të funksionojnë sipas orareve: 16.00-8.00 (e hënë-e premte); 24 orë (e shtunë, e dielë dhe ditë festash zyrtare)                               | 1 sistem alarmi me aksesoret ndihmës + sistem monitorimi |
| 6  | Ish zyrat UKE sha në NSHU (L: Dyli Haxhire)<br>Shërbim i ruajtjes me 1 (një) sistem alarmi me 2 sensorë, të funksionojnë sipas orareve: 16.00-8.00 (e hënë-e premte); 24 orë (e shtunë, e dielë dhe ditë festash zyrtare)                                    | 1 sistem alarmi me aksesoret ndihmës + sistem monitorimi |
|    | <b>Shuma</b>                                                                                                                                                                                                                                                 | <b>6</b>                                                 |

**Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:**

➤ Sistemet e Alarmit funksionojnë sipas orareve të parashikuara:

1. Sistemi të realizohet në mënyrë të integruar për të gjitha shërbimet (sistem alarmi, GPS) në mënyrë që të bëjë sa më të lehtë dhe më fleksibël monitorimin nga operatorët e qendrës së kontrollit.
2. Sistemet e Alarmit janë Sisteme teknologjike elektronike moderne për sinjalizimin e hyrjes apo dëmtimeve të paligjshme në ambjentin e marrë në sigurim.
3. Përgjegjësit e objekteve garantojnë aktivizimin dhe ç'aktivizimin e alarmit në momentin e mbylljes dhe hapjes së objektit.
4. Shoqëria e sigurisë mban përgjegjësi pas aktivizimit të sistemit të alarmit në rast se vjedhja apo dëmtimi i materialeve në objektin e siguruar ka ardhur si pasojë e neglizhencës së shërbimeve të kësaj shoqërie.
5. Montimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve të sistemit të alarmit janë përgjegjësi e shoqërisë private të sigurisë.
6. Sistemet e Alarmit të jenë me transmetim me GPRS, me sistem mbyllje me pult ose me tastierë me kod, me sensorë me kabëll ose me wireless.
7. Të gjitha shpenzimet e mirëmbajtjes, për pjesë ndërrimi, paisjet e zëvendësuar, zëvendësimin e baterive, sensorë të ndryshëm, DVR, Centrale të sistemeve të alarmit, kabëll rrjeti etj, gjatë procesit të shërbimit do të mbulohen nga vetë shoqëria e sigurimit për të gjithë kohën e parashikuar në kontratë.

2. Objektivat:

- Të ruajë objektin në zbatim të Rregullores së Brendshme të Autoritetit Kontraktor.
- Të ruajë rendin dhe të sigurojë jetën e personelit.

3.Detyrat e kontraktorit:

Kontraktori ka për detyrë:

- Të hartojë Rregulloren e Shërbimit dhe t'ja paraqesë Autoritetit Kontraktor.
- Të hartojë grafikun e shërbimit duke siguruar shërbimin e vazhdueshëm në të gjitha ditët e javës me turne dhe t'ja paraqesë çdo muaj Autoritetit Kontraktor duke përcaktuar emrat e punonjësve të shërbimit për çdo ditë dhe për çdo turn.
- Të ndërhyjë me grupin e gatshëm, në bazë të legjislacionit në fuqi, në çdo rast që paraqitet nevoja dhe të bashkëpunojë me policinë e rendit në interes të forcimit dhe të rritjes së efektshmërisë së veprimit në rast të cenimit të institucionit ose të personelit.

Punonjësi i shërbimit ka për detyrë:

- Të zbatojë Rregulloren e Shërbimit të hartuar nga Drejtuesi Teknik
- Të zbatojë Rregulloren e Brendshme të institucionit
- Të zbatojë grafikun për shërbimin me rojet private duke u paraqitur 10 minuta përpara dorëzimit të turnit.

- Të sigurojë ruajtjen dhe rendin në këtë objekt.
- Të mos lejojë futjen e personave në objekt pa fletë-hyrje.
- Të mos lejojë hyrjen dhe daljen e materialeve pa dokumentin përkatës.
- Të sigurojë parkimin e automjeteve të A.K sipas vendeve të përcaktuara nga institucioni.
- Të kontrollojë masat e sigurisë së objekteve si rrethimin, ndriçimin, gadishmërinë e sistemit të ndërlidhjes, mbrojtjes ndaj zjarrit dhe për çdo parregullsi të informojë duke vënë në dijeni përgjegjësën e tij dhe ky i fundit njofton personin e autorizuar të Autoritetit Kontraktor për çdo mangësi të konstatuar.
- Para marrjes së shërbimit, kontrollon objektin në prezencë të rojes dorëzuese dhe për ç'rregullimet e konstatuara njofton përgjegjësën e rojeve dhe përgjegjësën e shërbimeve të brendshme të institucionit, duke bërë shënimet përkatëse në librin e shërbimit.
- Të njohë dhe të zbatojë rregulloren për mbrojtjen kundra zjarrit. Në rast zjarri të marrë masa për shuarjen e tij dhe menjëherë njofton zjarrëfikset, përgjegjësën e rojeve dhe përgjegjësën e shërbimeve të brendshme të institucionit.
- Kur në objekt kryhen vepra penale, roja bën bllokimin e mjedisit dhe të autorit dhe njofton menjëherë organet kompetente
- Të jetë i pajisur me armë dhe ta përdorë atë në bazë të legjislacionit në fuqi.
- Të karakterizohet nga sjellja qytetare në komunikim me personat.
- Ndalohet futja dhe qëndrimi i rojës në ambjentet e brendshme të objektit përjashtuar rastet për zbatimin e rregullores.
- Rojas, gjatë kohës së shërbimit i ndalohet të pijë pije alkoolike, të flejë, të bisedojë me persona të jashtëm.
- Të bashkëpunojë me policinë e rendit në interes të forcimit dhe të rritjes së efektshmërisë së veprimit në rast të cenimit të institucionit ose të personelit.

## **NJËSIA E PROKURIMIT**